

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAČ/MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINETI PREDSIEDRA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 7582 Nr. i faq./Br.str/No.pg 61

Data/Datum/Date 01/07/26

RAHOVEC / ORAHOVAČ



Republika e Kosovës

Komuna e Rahovecit

Kabineti i Kryetarit



LISTA E VENDIMEVE TË MARRA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT, Z. SMAJL LATIFI

MUAJI QERSHOR 2026

Nr	Emri i vendimit	Nr. Protokollit
1.	Vendim për strehim të përkohshëm.	NRP-02-7422-2026
2.	Vendim për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit dhe blerjen e barnave për tretman të sëmundjes.	NRP-02-7424-2026
3.	Vendim për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit dhe blerjen e barnave për tretman të sëmundjes.	NRP-02-7425-2026
4.	Vendim për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit dhe blerjen e barnave për tretman të sëmundjes.	NRP-02-7426-2026
5.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës: <i>"Furnizimi me preparate për luftimin e insektit cikadia e hardhisë së rrushit"</i> .	NRP-02-7427-2026
6.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës: <i>"Furnizimi me pleh artificial"</i> .	NRP-02-7428-2026
7.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave: <i>"Rregullimi dhe mirëmbajtja e hidrosanitarisë në hapësira të jashtme dhe të brendshme në institucionet publike"</i> .	NRP-02-7431-2026
8.	Vendim për caktimin e Këshillit Organizues për nder të <i>"Ditës së Çlirimit"</i> në komunën e Rahovecit.	NRP-02-7435-2026
9.	Vendim për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: <i>"Insatlimi i ngrohjeve qendrore të reja, riparimi dhe mirëmbajtja e tyre"</i> .	NRP-02-7436-2026
10.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave: <i>"Rënimi i objekteve pa leje"</i> .	NRP-02-7438-2026
11.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave: <i>"Servisimi dhe mbushja e aparateve të zjarrfiksave-ritenderim"</i> .	NRP-02-7439-2026
12.	Vendim për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim me më pak se 1 vit të pronës së paluajtshme të komunës	NRP-02-7441-2026
13.	Vendim për lejimin e pagesës për punë jashtë orarit të punës.	NRP-02-7442-2026
14.	Vendim për mbulimin e shpenzimeve për pjesëmarrje në garë ndërkombëtare të atletikës.	NRP-02-7444-2026
15.	Vendim për mbulimin e shpenzimeve të pjesëmarrjes në garën e ekspeditës alpinistike në <i>"Mont Blanc"</i> .	NRP-02-7445-2026
16.	Vendim për mbulimin e shpenzimeve të pjesëmarrjes në garën e ekspeditës alpinistike në <i>"Mont Blanc"</i> .	NRP-02-7446-2026

17.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave: "Furnizimi me gypa PVC"	NRP-02-7447-2026
18.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës: <i>"Shërbime për të gjitha manifestimet e aktiviteteve kulturore"</i> .	NRP-02-7448-2026
19.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës: "Ndërtimi i serrave për fermerë me participim 80 %-20%.	NRP-02-7449-2026
20.	Vendim për miratimin e kërkesës për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).	NRP-02-7453-2026
21.	Vendim për transferimin e mësimdhënësit.	NRP-02-7458-2026
22.	Vendim për qasje në dokumente publike.	NRP-02-7460-2026
23.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës: <i>"Mirëmbajtja e objekteve kulturore dhe palestrës sportive "Mizahir Isma"</i> .	NRP-02-7462-2026
24.	Vendim për Dhënien e Dekorates "MEDALJA E LIRISË"	NRP-02-7465-2026
25.	Vendim për Dhënien e Dekorates "MEDALJA E LIRISË"	NRP-02-7466-2026
26.	Vendim për Dhënien e Dekorates "MEDALJA E LIRISË"	NRP-02-7467-2026
27.	Vendim për Dhënien e Dekorates "MEDALJA E LIRISË"	NRP-02-7468-2026
28.	Vendim për Dhënien e Dekorates "MEDALJA E LIRISË"	NRP-02-7469-2026
29.	Vendim për Dhënien e Dekorates "MEDALJA E LIRISË"	NRP-02-7470-2026
30.	Vendim për Dhënien e Dekorates "MEDALJA E LIRISË"	NRP-02-7471-2026
31.	Vendim për Dhënien e Dekorates "MEDALJA E LIRISË"	NRP-02-7472-2026
32.	Vendim për Dhënien e Dekorates "MEDALJA E LIRISË"	NRP-02-7473-2026
33.	Vendim për Dhënien e Dekorates "MEDALJA E LIRISË"	NRP-02-7474-2026
34.	Vendim për Dhënien e Dekorates "MEDALJA E LIRISË"	NRP-02-7475-2026
35.	Vendim për Dhënien e Dekorates "MEDALJA E LIRISË"	NRP-02-7476-2026
36.	Vendim për Dhënien e Dekorates "MEDALJA E LIRISË"	NRP-02-7477-2026
37.	Vendim për Dhënien e Dekorates "MEDALJA E LIRISË"	NRP-02-7478-2026
38.	Vendim për Dhënien e Dekorates "MEDALJA E LIRISË"	NRP-02-7479-2026
39.	Vendim për Dhënien e Dekorates "MEDALJA E LIRISË"	NRP-02-7480-2026
40.	Vendim për Dhënien e Dekorates "MEDALJA E LIRISË"	NRP-02-7481-2026
41.	Vendim për Dhënien e Dekorates "MEDALJA E LIRISË"	NRP-02-7482-2026
42.	Vendim për Dhënien e Dekorates "MEDALJA E LIRISË"	NRP-02-7483-2026
43.	Vendim për Dhënien e Dekorates "MEDALJA E LIRISË"	NRP-02-7484-2026
44.	Vendim për Dhënien e Dekorates "MEDALJA E LIRISË"	NRP-02-7485-2026
45.	Vendim për Dhënien e Dekorates "MEDALJA E LIRISË"	NRP-02-7486-2026
46.	Vendim për Dhënien e Dekorates "MEDALJA E LIRISË"	NRP-02-7487-2026
47.	Vendim për Dhënien e Dekorates "MEDALJA E LIRISË"	NRP-02-7488-2026
48.	Vendim për Dhënien e Dekorates "MEDALJA E LIRISË"	NRP-02-7489-2026
49.	Vendim për Dhënien e Dekorates "MEDALJA E LIRISË"	NRP-02-7490-2026

50.	Vendim për Dhënien e Dekorates "MEDALJA E LIRISË"	NRP-02-7491-2026
51.	Vendim për Dhënien e Dekorates "MEDALJA E LIRISË"	NRP-02-7492-2026
52.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave: <i>"Trajtimi i qenve endacak në komunën e Rahovecit"</i>	NRP-02-7493-2026
53.	Vendim për emërimin e drejtorit të përkohshëm të drejtorit të ShFMU "Isa Boletini.	NRP-02-7496-2026
54.	Vendim për caktimin e grupit punues për hartimin e Planit Operativ Emergjent në Komunën e Rahovecit	NRP-02-7497-2026
55.	Vendim për Dhënien e Dekorates "MEDALJA E LIRISË"	NRP-02-7501-2026
56.	Vendim për dhënien e pushimit nga puna pa pagesë.	NRP-02-7504-2026
57.	Vendim për dhënien e pushimit nga puna pa pagesë.	NRP-02-7505-2026
58.	Vendim për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve me një ndryshim të vogël tek anëtarët e komisionit.	NRP-02-7509-2026
59.	Vendim për kolaodimin e pozicioneve në kontratën me titull: <i>"Ndërtimi i rrugës Sapniq – Nashpall"</i>	NRP-02-7513-2026
60.	Vendim për caktimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave kundër aktvendimeve të Drejtorisë për Inspektim.	NRP-02-7516-2026
61.	Vendim për Dhënien e Dekorates "Ukshin Hoti"	NRP-02-7524-2026
62.	Vendim për fromimin e Grupit i vlerësimit për klasifikimin e pozitive të punës dhe hartimin e draft formularëve për përshkrimin e detyrave të punës për kategorinë profesionale në Komunën e Rahovecit.	NRP-02-7525-2026
63.	Vendim për miratimin e kërkesës për mbështetje nga Masat Emergjente të Riintegritimit.	NRP-02-7526-2026
64.	Vendim për qasje në dokumente publike.	NRP-02-7534-2026
65.	Vendim për pezullimin e marrdhënies së punës	NRP-02-7536-2026
66.	Vendim për pezullimin e marrdhënies së punës	NRP-02-7537-2026
67.	Vendim për pezullimin e marrdhënies së punës	NRP-02-7538-2026
68.	Vendim për pezullimin e marrdhënies së punës	NRP-02-7539-2026
69.	Vendim për pezullimin e marrdhënies së punës	NRP-02-7540-2026
70.	Vendim për miratimin e kërkesës për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit dhe blerjen e barnave për tretman të sëmundjes.	NRP-02-7541-2026
71.	Vendim për miratimin e kërkesës për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit dhe blerjen e barnave për tretman të sëmundjes.	NRP-02-7542-2026
72.	Vendim për miratimin e kërkesës për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit dhe blerjen e barnave për tretman të sëmundjes.	NRP-02-7543-2026
73.	Vendim për miratimin e kërkesës për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit dhe blerjen e barnave për tretman të sëmundjes.	NRP-02-7544-2026
74.	Vendim për miratimin e kërkesës për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit dhe blerjen e barnave për tretman të sëmundjes.	NRP-02-7545-2026
75.	Vendim për miratimin e kërkesës për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit dhe blerjen e barnave për tretman të sëmundjes.	NRP-02-7546-2026
76.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës: <i>"Sigurimi shëndetësor për nxënësit parashkollorë-Çerdhe"</i>	NRP-02-7551-2026
77.	Vendim për caktimin e komisionit për zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2025.	NRP-02-7554-2026

78.	Vendim për miratimin e kërkesës për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit dhe blerjen e barnave për tretman të sëmundjes.	NRP-02-7555-2026
79.	Vendim për miratimin e kërkesës për punë shtesë në projektin <i>"Ndërtimi i aneksit të ShFMU "Katër Dëshmorët" në Ratkoc"</i>	NRP-02-7558-2026
80.	Vendim për emërimin e nënkryetarit të Komunës	NRP-02-7559-2026
81.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave: <i>"Ofrimi i shërbimeve të sigurimit fizik të objekteve të Komunës së Rahovecit"</i> .	NRP-02-7563-2026
82.	Vendim për caktimin e zyrtarit përgjegjës për raportim dhe kordinim me Zyrën për Administrimin e Pronës Publike.	NRP-02-7565-2026
83.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave: <i>"Hartimi i projekteve të ndryshme"</i>	NRP-02-7573-2026
84.	Vendim për caktimin e komisionit për rivlerësimin e ofertave: <i>"Furnizimi me rekuizita për nevojat e Komunës"</i>	NRP-02-7574-2026



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET	
Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)	
Nr./Br./No <u>7422</u>	Nr. i faq./Br.str./No.pg <u>45</u>
Data/Datum/Date <u>1 / 6 / '26</u>	
RAHOVEC / ORAHOVAC	

Në mbështetje të nenit 13, nenit 17 pika k) dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008"), nenit 12 pika 12.1, 12.4 dhe 12.5 të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.11, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, dhe kërkesës së Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, të datës 29.5.2026, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për strehim të përkohshëm

1. **Miratohet** kërkesa e [redacted] nga Rahoveci, për strehim të përkohshëm emergjent, si rast në nevojë sociale, në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh, respektivisht prej datës 1.6.2026 deri më 1.12.2026, te familja strehuese e [redacted] nga Rahoveci.
2. Pagesa në emër të qirasë mujore, sipas pikës 1 të këtij vendimi, do të jetë në shumën prej **150.00€ (njëqind e pesëdhjetë euro)** për çdo muaj.
3. **Autorizohet** Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Komunën e Rahovecit, që të lidhë marrëveshje për strehim të përkohshëm të familjes në nevojë.
4. Përfutuese sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi është Shqipe Haxhimurati nga Rahoveci, me familje.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
6. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Arsyetim

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Komunën e Rahovecit, ka pranuar kërkesë nga [redacted] nga Rahoveci për ndihmë për strehim, pasi nuk ka shtëpi për banim.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale ka dalë në vendin e ngjarjes dhe ka vizituar parashtruesen e kërkesës, me ç'rast ka konstatuar që është duke jetuar përkohësisht në një shtëpi në kushte të vështira jetese.

Andaj, duke marrë parasysh nevojën për ndihmë të familjes së lartpërmendur, e cila është duke jetuar në kushte të vështira ekonomike dhe që e njëjta e ka të pamundur mbulimin e shpenzimeve për jetesë dhe pagesën e qirasë, është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje.

Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim, ka të drejtën e ankesës në komisionin e ankesave në Komunën e Rahovecit, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të tij.

Vendimi u dërgohet:

- [Redacted] nga Rahoveci,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNES / PRESEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7424 Nr. i faq./Br.str./No.pg 45
Data/Datun/Date 1 / 6 / 2026
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.1 dhe 2.2 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me nr. 1427, të datës 28.4.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [redacted] nga Rahoveci, me nr. prot. 1632, e datës 24.4.2026, për ndihmë financiare prej 300.00€ (treqind euro), për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit dhe blerjen e barnave për tretman të sëmundjes.
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Arsyetim

[redacted] nga Rahoveci, vuan nga sëmundja e rëndë, e cila ka nevojë për intervenim përmes operacionit, si dhe për tretman të vazhdueshëm për shërimin e saj.

Shërimi i sëmundjes për të lartpërmendurën ka kosto të lartë financiare të papërbalueshme për të dhe për familjen e saj.

Andaj, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore dhe financiare të të lartpërmendurës, pasi shpenzimet e mjekimit dhe të blerjes së barnave kanë kosto të lartë financiare, ajo e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë dhe blerjen e barnave për shërimin e sëmundjes, kështu që është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- [redacted] nga Rahoveci,
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESIEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 7425 Nr. i faq./Br.str/No.pg 45

Data/Datum/Date 1 / 6 / 2026

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.1 dhe 2.2 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, me nr. 1427, të datës 28.4.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa [redacted] nga Rahoveci, me nr. prot. 1453, e datës 8.4.2026, për ndihmë financiare prej 300.00€ (treqind euro), për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit dhe blerjen e barnave për tretman të sëmundjes.
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Arsyetim

[redacted] nga Rahoveci, vuan nga sëmundja e rëndë, e cila ka nevojë për intervenim përmes operacionit, si dhe për tretman të vazhdueshëm për shërimin e saj.

Shërimi i sëmundjes për të lartpërmendurën ka kosto të lartë financiare të papërbalueshme për të dhe për familjen e saj.

Andaj, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore dhe financiare të të lartpërmendurës, pasi shpenzimet e mjekimit dhe të blerjes së barnave kanë kosto të lartë financiare, ajo e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë dhe blerjen e barnave për shërimin e sëmundjes, kështu që është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- [redacted] nga Rahoveci,
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 7426 Nr. i faq/Br.str/No.pg 45

Data/Datum/Date 1 16 2026

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi I dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.1 dhe 2.2 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, me nr. 1427 të datës 28.4.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa [redacted] nga Rahoveci, me nr. prot. 1864, e datës 18.5.2026, për ndihmë financiare prej 300.00€ (treqind euro), për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit dhe blerjen e barnave për tretman të sëmundjes.
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

[redacted] nga Rahoveci, vuan nga sëmundja e rëndë, i cili ka nevojë për intervenim përmes operacionit, si dhe për tretman të vazhdueshëm për shërim.

Shërimi i sëmundjes për të lartpërmendurin ka kosto të lartë financiare të papërballueshme për të dhe për familjen e tij.

Andaj, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore dhe financiare të të lartpërmendurit, pasi shpenzimet e mjekimit dhe të blerjes së barnave kanë kosto të lartë financiare, ai e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë dhe blerjen e barnave për shërimin e sëmundjes, kështu që është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- [redacted] nga Rahoveci,
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 7427 Nr. i faq./Br.str/No.pg 45

Data/Datum/Date 1 / 6 / 2026

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjësit të Njesisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Furnizim me preparate për luftimin e insektit cikadia e hardhisë së rrushit", me numër të kontratës: 623-26-2966-1-2-1/C708, si në vijim:
 - 1.1.Blerim Sokoli, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës: Zyrtare për bujqësi, në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, **CAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2.Behar Thaqi, Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të Menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit të Menaxherit i Kontratës.
3. Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës janë:
 - 3.1. Menaxheri i kontratës do të menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuara në kontratë;
 - 3.2. Menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë; dhe
 - 3.3. Menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.
4. Funksionet e Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë:
 - 4.1. Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës, duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të Kontratës

- nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i kontratës brenda afatit, duhet të krijojë Planin për Menaxhim të kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";
- 4.2. Menaxheri i kontratës, duhet të lexojë kushtet e kontratës dhe të përgatisë Planin e Menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me Operatorin Ekonomik;
- 4.3. Të dorëzojë Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyrë të Prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerrë urdhërblenjen;
- 4.4. Pas pranimit të urdhërblenjes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendosë të dhënat në platformën elektronike, të ngarkojë në platformën elektronike urdhërblenjen dhe ta përcjellë përmes platformës tek OE-ja, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;
- 4.5. Të sigurojë që Operatori Ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës, apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- 4.6. Të sigurojë që Operatori Ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- 4.7. Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet e tjera, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- 4.8. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, të cilësisë, dhe të kohës aty ku është e përshtatshme;
- 4.9. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
- 4.10. Të sigurojë që të gjithë regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, të mbahen dhe të arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës, në sistem të prokurimit elektronik;
- 4.11. Të nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim, nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- 4.12. Të sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit dhe ta marrë miratimin;
- 4.13. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, të mallrave dhe të shërbimeve;
- 4.14. Të japë detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit; dhe
- 4.15. Të dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit, ose nga ZKA-ja.
5. Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, janë:
- 5.1. Monitorimi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës; dhe
- 5.2. Rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave, nën mbikëqyrjen e tij.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- *Menaxheri i kontratës,*
- *Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,*
- *Spektori i Prokurimit, dhe*
- *Arkivi.*


Smajl Latifi
Kryetar i Komunës
Zyrtar Kryesor Administrativ



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 7428 Nr. i faq./Br.str./No.pg 45

Data/Datum/Date 7/6/2026

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjësit të Njesisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Furnizim me pleh artificial", me numër të kontratës: 623-26-2997-1-2-1/C709, si në vijim:
 - 1.1.Blerim Sokoli, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës: Zyrtare për bujqësi, në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, **CAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2.Behar Thaqi, Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualet për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të Menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit të Menaxherit i Kontratës.
3. Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës janë:
 - 3.1. Menaxheri i kontratës do të menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuara në kontratë;
 - 3.2. Menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë; dhe
 - 3.3. Menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.
4. Funksionet e Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë:
 - 4.1. Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës, duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të Kontratës

nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i kontratës brenda afatit, duhet të krijojë Planin për Menaxhim të kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";

- 4.2. Menaxheri i kontratës, duhet të lexojë kushtet e kontratës dhe të përgatisë Planin e Menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me Operatorin Ekonomik;
 - 4.3. Të dorëzojë Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyrë të Prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerrë urdhërblërjen;
 - 4.4. Pas pranimit të urdhërblërjes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendosë të dhënat në platformën elektronike, të ngarkojë në platformën elektronike urdhërblërjen dhe ta përcjellë përmes platformës tek OE-ja, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;
 - 4.5. Të sigurojë që Operatori Ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës, apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.6. Të sigurojë që Operatori Ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.7. Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet e tjera, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.8. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, të cilësisë, dhe të kohës aty ku është e përshtatshme;
 - 4.9. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
 - 4.10. Të sigurojë që të gjithë regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, të mbahen dhe të arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës, në sistem të prokurimit elektronik;
 - 4.11. Të nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim, nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.12. Të sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit dhe ta marrë miratimin;
 - 4.13. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, të mallrave dhe të shërbimeve;
 - 4.14. Të japë detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit; dhe
 - 4.15. Të dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit, ose nga ZKA-ja.
5. Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, janë:
- 5.1. Monitorimi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës; dhe
 - 5.2. Rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave, nën mbikëqyrjen e tij.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- *Menaxheri i kontratës,*
- *Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,*
- *Spektori i Prokurimit, dhe*
- *Arkivi.*


Smajl Latifi
Kryetar i Komunës
Zyrtar Kryesor Administrativ



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality of Orahovac

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njesia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 7431 Nr. i faq/Br.str/No.pg 46

Data/Datum/Date 21.6.2026

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011"), nenit 37 të Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, nenit 69 dhe nenit 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

- Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Rregullimi dhe mirëmbajtja e hidrosanitarisë në hapësira të jashtme dhe të brendshme në institucionet publike", me nr. prokurimi: 623-26-2269-2-1-1 dhe me nr. të brendshëm: 623-26-012-2-1-1, të datës 1.6.2026, në këtë përbërje:
 - 1.1. Egzon Thaqi, kryesues,
 - 1.2. Enise Dina, anëtare,
 - 1.3. Vjollca Berisha, anëtare.
- Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin: "Rregullimi dhe mirëmbajtja e hidrosanitarisë në hapësira të jashtme dhe të brendshme në institucionet publike", me nr. prokurimi: 623-26-2269-2-1-1 dhe me nr. të brendshëm: 623-26-012-2-1-1, të datës 1.6.2026.
- Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
- Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.
- Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 7435 Nr. i faq./Br.str./No.pg 46

Data/Datum/Date 2 / 6 / 26

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 8 paragrafi 1 pika 1.3, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

Për caktimin e Këshillit Organizues për nder të "Ditës së Çlirimit" në komunën e Rahovecit

1. Caktohet Këshilli Organizues për nder të "Ditës së Çlirimit" në komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:
 - 1.1 Betim Zllanoga, kryesues
 - 1.2 Atdhe Rama, anëtar
 - 1.3 Afrim Dina, anëtar
 - 1.4 Muhamet Morina, anëtar
 - 1.5 Besmire Bytyqi, anëtare
 - 1.6 Nora Boshnjaku, anëtare
 - 1.7 Naser Dula, anëtar
 - 1.8 Afrim Oruqi, anëtar
 - 1.9 Dervish Qadraku, anëtar
 - 1.10 Qemajl Krasniqi, anëtar
 - 1.11 Muhareme Morina, anëtare
 - 1.12 Feriz Thaqi, anëtar
 - 1.13 Nadir Sylejmani, anëtar
 - 1.14 Fehmi Hoxha, anëtar
 - 1.15 Blerta Gashi, anëtare
2. Këshilli Organizues për nder të "Ditës së Çlirimit" në komunën e Rahovecit, ka për detyrë të shpërndajë ftesat për grupe dhe individë të rëndësishëm, të caktoj datën, orën dhe vendin ku do të zhvillohen aktivitetet.
3. Obligohet Këshilli Organizues që të hartoj raport të detajuar për Kryetarin e Komunës mbi mbarëvajtjen dhe shpenzimet e organizimit të "Ditës së Çlirimit", në komunën e Rahovecit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryesuesi dhe të gjithë anëtarët e Këshillit Organizues.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Anëtarët e Këshillit Organizues, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



	REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESIDENKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR'S CABINET	
Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)		
Nr./Br./No <u>7436</u> Nr. i faq./Br.str./No.pg <u>46</u>		
Data/Datum/Date <u>2 / 6 / 26</u>		
RAHOVEC / ORAHOVAC		

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 28 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011"), nenit 19 paragrafi 19.16 i Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: "Instalimi i ngrohjeve qendrore të reja, riparimi dhe mirëmbajtja e tyre"

1. Egzon Thaqi, **emërohet** person përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: "Instalimi i ngrohjeve qendrore të reja, riparimi dhe mirëmbajtja e tyre".
2. Personi përgjegjës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, ka për detyrë që të bëjë hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës, duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik dhe Rregulloren Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.
3. Përgjegjësitë e personit për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës, janë:
 - 3.1. Në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuar drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomikë, në përputhje me nenin 28 Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe akteve nënligjore (legjislacionit dytësor);
 - 3.2. Në atë mënyrë që nuk favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomikë;
 - 3.3. Të cilat nuk i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, një procesi të hollësishëm, ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë, ose ndonjë prodhimi.

4. Personi përgjegjës obligohet që të hartojë specifikimet teknike / termat e referencës deri më datë 8.6.2026.
5. Personi përgjegjës obligohet që, së bashku me specifikimet teknike / termat e referencës, të dorëzojë edhe deklaratën në betim, të nënshkruar te Njësia e Prokurimit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- *Admirim Durguti,*
- *Drejtoria për Arsim,*
- *Njësia e Prokurimit, dhe*
- *Arkivi.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



	REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET	
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)		
Nr./Br./No <u>7438</u> Nr. i faq./Br.str./No.pg <u>46</u>		
Data/Datum/Date <u>03 / 06 / 26</u>		
RAHOVEC / CRAHOVAC		

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011"), nenit 37 të Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, nenit 69 dhe nenit 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

- 1. Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Rrënimi i objekteve pa leje", me Nr. prokurimi: 623-26-2568-2-1-1 dhe Nr. të brendshëm 623-26-014-2-1-1 të datës: 2.6.2026, në këtë përbërje:
 - 1.1. Egzon Thaqi, kryesues
 - 1.2. Bekim Krasniqi, anëtar
 - 1.3. Veton Kabashi, anëtar
2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin: "Rrënimi i objekteve pa leje", me Nr. prokurimi: 623-26-2568-2-1-1 dhe Nr. të brendshëm 623-26-014-2-1-1 të datës: 2.6.2026.
3. Obligohet komisioni që këto punë ti kryej duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine

Municipal Mayor

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINETI PRESEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 7439 Nr. i faq/Br.str/No.pg 46

Data/Datum/Date 3 / 6 / 2026

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011"), nenit 37 të Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, nenit 69 dhe nenit 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Servisimi dhe mbushja e aparateve të zjarrfiksave - ritenderim", me nr. prokurimi: 623-26-3800-2-3-6 dhe me nr. të brendshëm: 623-26-001-2-3-6, të datës 2.6.2026, në këtë përbërje:
 - 1.1. Egzon Thaqi, kryesues,
 - 1.2. Enise Dina, anëtare,
 - 1.3. Vjollca Berisha, anëtare.
2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin: "Servisimi dhe mbushja e aparateve të zjarrfiksave - ritenderim", me nr. prokurimi: 623-26-3800-2-3-6 dhe me nr. të brendshëm: 623-26-001-2-3-6, të datës 2.6.2026.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 7441 Nr. i faq./Br.str./No.pg 47

Data/Datum/Date 4 / 6 / 2026

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008"), dhe nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, nenit 10 paragrafi 2 i Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës 01 Nr. 197/21, të datës 28.5.2021, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim më pak se një (1) vjet të pronës së paluajtshme të komunës

- Formohet komisioni për dhënien në shfrytëzim më pak se një (1) vjet të pronës së paluajtshme të komunës, në kuadër Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, në këtë përbërje:**
 - 1.1. Fidan Hoti, kryesues,
 - 1.2. Mirsad Shala, anëtar,
 - 1.3. Agnesa Ramadani, anëtare.
- Komisioni ka për detyrë që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga parashtrimi i kërkesës të bëjë shqyrtimin e kërkesës, të konstatojë gjendjen faktike në terren dhe në fund të bëjë raport përfundimtar dhe të rekomandojë palën përfituese në bazë të kërkesave të parashtruara.
- Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në Rregulloren për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vjet të pronës së paluajtshme të komunës 01 Nr. 197/21, të datës 28.5.2021.
- Mandati i komisionit për dhënien në shfrytëzim më pak se një (1) vjet të pronës së paluajtshme të komunës, në kuadër Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, do të jetë 1 (një) vjet.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, dhe
- Arkivit.





Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 21 të Ligjit për Pagat e nëpunësve civilë, nr.03/L-147 të datës 13.05.2010 dhe nenit 11 të Rregullores Nr. 33/2012 për shtesat në pagat dhe kompensimet e tjera të nëpunësve civilë, neneve 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M PËR LEJIMIN E PAGESËS PËR PUNË JASHTË ORARIT TË PUNËS

1. Me këtë vendim **LEJOHET** pagesa për punë shtesë jashtë orarit të punës për Zymryte Nurkasën, e cila është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe e sistemuar në punë dhe në detyra të punës: Zyrtare e Gjendjes Civile në Rahovec, Drejtoria për Administratë në Komunën e Rahovecit.
2. Vlera e pagesës për punë shtesë **jashtë orarit të punës** është 30 (tridhjetë euro) për kryerjen e punës, respektivisht, zhvillimin e ceremonisë së martesës - kurorëzimit jashtë objektit të Komunës së Rahovecit, më 30.5.2026. Ceremonia e martesës – kurorëzimi, është kryer jashtë Zyrës së Gjendjes Civile në Rahovec, në mes të çiftit Januz Gashi dhe Blerta Vehapi.
3. Mjetet për pagesën e punëve jashtë orarit të rregullt të punës sigurohen nga kodi: Paga dhe Mëditje.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Me kërkesën e Zymryte Nurkasës, e cila është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe e sistemuar në punë dhe në detyra të punës: Zyrtare e Gjendjes Civile në Rahovec, në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Rahovecit dhe me autorizimin e drejtorit të Drejtorisë për Administratë, të datës 29.5.2026, punëtorja e cekur më lart, ka marrë pjesë më 30.5.2026 në kurorëzimin të shtetasve të Republikës së Kosovës jashtë zyrës së gjendjes civile të Komunës së Rahovecit, të çiftit Januz Gashi nga Nagaci dhe Blerta Vehapi nga Dragashi. Ceremonia është zhvilluar në restorantin “Oferta events”.

Prandaj, për shkak të kryerjes së punës - lidhjes së kurorëzimit jashtë orarit të punës, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, është e domosdoshme që të bëhet pagesa për kryerjen e punës.

Me vendim të njoftohen:

- Zymryte Nurkasa, zyrtare e Gjendjes Civile në Rahovec,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Zyra e Personelit, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac / Municipality of Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESIDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7444 Nr. i faq./Br.str./No.pg 47
Data/Datumi/Date 4 / 6 / 2026
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 22 paragrafi 1 pika 1.3 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e grupit punues për hartimin e Planit Operativ Emergjent në Komunën e Rahovecit

1. **Caktohet** grupi punues për hartimin e Planit Operativ Emergjent në Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:
 - 1.1. Irfan Berisha – drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, kryesues,
 - 1.2. Altin Zhuniqi – drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, kryesues,
 - 1.3. Afrim Limani - drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, koordinator,
 - 1.4. Afrim Dina - drejtor i Drejtorisë për Administratë, anëtar,
 - 1.5. Afrim Oruqi - drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtar,
 - 1.6. Muhamet Morina - drejtor i Drejtorisë për Arsim, anëtar,
 - 1.7. Albnor Mullabazi - drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtar,
 - 1.8. Besmire Bytyqi – drejtoreshë e Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, anëtare,
 - 1.9. Përparim Krasniqi - drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, anëtar,
 - 1.10. Behar Thaqi – drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, anëtar,
 - 1.11. Nora Boshnjaku - drejtoreshë e Drejtorisë për Inspektim, anëtare,
 - 1.12. Atdhe Rama - drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar,
 - 1.13. Beqir Hamza - Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtar,
 - 1.14. Sami Boshnjaku- Komandant i NJPZSh-Rahovec, anëtar,
 - 1.15. Fazli Morina - Policia e Kosovës, anëtar,
 - 1.16. Behar Berisha - KEDS, anëtar,
 - 1.17. Hamid Mullaabazi - KRU "Gjakova", anëtar,
 - 1.18. Mentor Durguti - Ekoregjioni, anëtar,
 - 1.19. Qazim Hoti – EKO "Drinia", anëtar,
 - 1.20. Qerim Cena - Kryqi i Kuq, anëtar,
 - 1.21. Qemajl Krasniqi - OJQ, anëtar.
2. Grupi punues ka për detyrë që të hartojë Planin Operativ Emergjent në Komunën e Rahovecit.
3. Obligohet grupi punues që të veprojë duke u bazuar në ligjet dhe në aktet nënligjore në fuqi në Republikën e Kosovës.

4. Grupi punues do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Obligohet grupi punues që, pas përfundimit të punëve, të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe për Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të grupit punues,*
- *Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, dhe*
- *Arkivit*





Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Komuna Rahovec
Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Mayor Office



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7501 Nr. i faq./Br.str./No.pg. 53
Data/Datum/Date 12 / 06 / 2026
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008"), nenit 4 paragrafi 2 dhe nenit 7 të Rregullores për dhënien e titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Rahovecit, me Nr. Prot. 01, Nr. 327/22, të datës 31.5.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të OVL të UÇK-së, dega në Rahovec, të datës 10.06.2026, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për

Dhënien e Dekoratës "MEDALJA E LIRISË"

1. Me këtë vendim, Dekorata "MEDALJA E LIRISË" i jepet Pajazit Thaçit nga fshati Dobidol, komuna e Rahovecit.
2. Kjo dekoratë i jepet me rastin e 27-vjetorit të çlirimit të Rahovecit me rrethinë, për kontributin e dhënë në luftën për çlirimin e Kosovës, përkatësisht për kontributin e dhënë në kuadër të Brigadës 124 "Gani Paçarizi" të UÇK-së, e cila ka operuar në rajonin e Rahovecit në periudhën e luftës 1998/99, si dhe për ruajtjen dhe për kultivimin e vlerave kombëtare.
3. Bartësi i Dekoratës "MEDALJA E LIRISË" nënshkruhet formalisht në regjistrin e bartësve të titujve të nderit, të dekoratave dhe të çmimeve të Komunës së Rahovecit.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Pajazit Thaçit nga fshati Dobidol, komuna e Rahovecit,
- OVL të UÇK-së, dega në Rahovec, dhe
- Arkivit.



Smajl Latifi
Smajl Latifi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA ORAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESIDENTIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7504 Nr. i faq/Br.str/No.pg 53
Data/Datum/Date 15 / 06 / 26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 21 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2023"), nenit 15 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 për orarin e punës, pushimet dhe vijueshmërinë e zyrtarëve publik, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, si dhe kërkesës së Saranda Haxhijaha – Tara, me nr. prot. 2057, të datës 10.6.2026, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për dhënien e pushimit nga puna pa pagesë

1. **Miratohet** kërkesa për pushim pa pagesë e Saranda Haxhijaha-Tara nga Rahoveci, e sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: mjeke stomatologe në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec, nga data 1.7.2026 deri më datë 31.8.2026.
2. Të lartpërmendurës në pikën 1 të këtij vendimi i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtës së rikthimit në pozitën e mëparshme pas kalimit të afatit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Obligohet zyrtari/ja për paga në Komunën e Rahovecit që ta largojë nga lista e pagës të lartpërmendurën për periudhën sipas pikës 1 të këtij vendimi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Njësia e Personelit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Saranda Haxhijaha-Tara nga Rahoveci, e sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: mjeke stomatologe në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec, ka parashtruar kërkesë me nr. prot. 2057, të datës 10.6.2026, me të cilën ka kërkuar pushim pa pagesë nga data 1.7.2026 deri me datë 31.8.2026.

Kërkesën e lartpërmendura e ka parashtruar për arsye familjare, respektivisht për kujdesin ndaj 4 (katër) fëmijëve të mitur të moshave 2, 5, 7 dhe 9 vjeç.

Gjatë kësaj periudhe, të lartpërmendurës i pushojnë të drejtat dhe detyrat e marrëdhënies së punës, përveç të drejtës së rikthimit në pozitën e mëparshme pas kalimit të afatit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

Pas administrimit të të gjitha provave, duke u bazuar në nenin 21 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 15 të Rregullores (QRK) nr. 04/2024 për orarin e punës, pushimet dhe vijueshmërinë



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 21 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2023"), nenit 15 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 për orarin e punës, pushimet dhe vijueshmërinë e zyrtarëve publik, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, si dhe kërkesës së Artan Berishës me nr. prot. 2059, të datës 10.6.2026, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për dhënien e pushimit nga puna pa pagesë

1. **Miratohet** kërkesa për pushim pa pagesë e Artan Berishës nga fshati Drenoc, komuna e Rahovecit, i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: mjek stomatolog në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec, nga data 15.6.2026 deri më datë 1.9.2026.
2. Të lartpërmendurit në pikën 1 të këtij vendimi i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtës së rikthimit në pozitën e mëparshme pas kalimit të afatit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Obligohet zyrtari/ja për paga në Komunën e Rahovecit që ta largojë nga lista e pagës të lartpërmendurin për periudhën sipas pikës 1 të këtij vendimi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Njësia e Personelit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Artan Berisha nga fshati Drenoc, komuna e Rahovecit, i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: mjek stomatolog në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec, ka parashtruar kërkesë me nr. prot. 2059, të datës 10.6.2026, me të cilën ka kërkuar pushim pa pagesë nga data 15.6.2026 deri më datë 1.9.2026.

Kërkesën i lartpërmenduri e ka parashtruar për arsye shëndetësore.

Gjatë kësaj periudhe, të lartpërmendurit i pushojnë të drejtat dhe detyrat e marrëdhënies së punës, përveç të drejtës së rikthimit në pozitën e mëparshme pas kalimit të afatit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

Pas administrimit të të gjitha provave, duke u bazuar në nenin 21 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 15 të Rregullores (QRK) nr. 04/2024 për orarin e punës, pushimet dhe vijueshmërinë e zyrtarëve publikë, është konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që zyrtari publik ta shfrytëzojë pushimin pa pagesë.

Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të vendimit, në komisionin për shqyrtimin e ankesave për nëpunësit e shërbimit publik në kuadër të Komunës së Rahovecit.

Me vendim të njoftohen:

- *Artan Berisha nga fshati Drenoc,*
- *Drejtorja për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,*
- *Drejtorja për Buxhet dhe Financa,*
- *Zyrtari/ja për paga,*
- *Njësia e Personelit, dhe*
- *Arkivi.*

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECI/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS/KABINETI PRESIEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7509 Nr. i faq/Br.str/No.pg 53
Data/Datumi/Date 15 / 06 / 26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, i datës 29.03.2017, nenit 5, 7 dhe 8 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Sobvencineve Nr.1427 e datës 28.04.2017, Thirrjes publike për aplikim me Nr. Prot. 1878 të datës 18.05.2026, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve

- Caktohet** komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve sipas Thirrjes publike për aplikim “Përkrahja e fermerëve me preparate për luftimin e insektit “CIKADIA” dhe trajtim me dron në vreshtat e hardhisë së rrushit” me Nr. Prot. 1878 të datës 18.05.2026, në këtë përbërje:
 - 1.1 Kosovare Gashi, kryesuese
 - 1.2 Dhurata Rrustemi, anëtare
 - 1.3 Kaltrina Popaj, anëtare
 - 1.4 Izet Morina, anëtar
 - 1.5 Nazmi Bellaqa, anëtare nga shoqëria civile
- Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të fermerëve që kanë aplikuar në Thirrjen publike për aplikim “Përkrahja e fermerëve me preparate për luftimin e insektit “CIKADIA” dhe trajtim me dron në vreshtat e hardhisë së rrushit” me Nr. Prot. 1878 të datës 18.05.2026 të shpallur nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
- Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në dispozitat e Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Sobvencineve Nr.1427 e datës 28.04.2017 dhe kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Thirrjen publike për aplikim me Nr. Prot. 1878 të datës 18.05.2026 të shpallur nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
- Komisioni do të filloj punën menjëherë dhe ka mandat deri në përfundimin e procedurës së shpalljes së përfituesve.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINETI PRESËDIKË OPŠTINË / MUNICIPAL MAYOR CABINET	
Njësia Nr./Br./No	02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No	7513
Nr. i faq./Br.str./No.pg.	54
Data/Datum/Date	15/06/26
RAHOVEC / ORAHOVAC	

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), dispozitave të Ligjit 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011”), dispozitave të Rregullores Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kontratës me titull “Ndërtimi i rrugës Sapniq - Nashpall” me Nr. të Prokurimit 623-24-7151-5-1-1/C631, kërkesës dhe rekomandimit të menaxherit të kontratës me Nr. Prot. 1961 të datës 29.5.2026, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ndërrimin (kolaodimin) e pozicioneve në kontratën me titull “Ndërtimi i rrugës Sapniq - Nashpall”

1. Me këtë vendim **lejohet** ndërrimi (kolaodimi) i pozicioneve të situacionit nga një pozicion në tjetrin, në kontratën me titull “Ndërtimi i rrugës Sapniq - Nashpall” me Nr. të Prokurimit 623-24-7151-5-1-1/C631.
2. Ndërrimi (kolaodimi) i pozicioneve sipas pikës 1 të këtij vendimi do të bëhet nga pozicioni i kontratës: AKSI I - 6. INSTALIMET NËNTOKSORE – Pozicioni 6.1 dhe 6.2 dhe AKSI II – 6. INSTALIMET NËNTOKËSORE – Pozicioni 6.1 dhe 6.2, në pozicionet e domosdoshme për realizim: AKSI I – 2. PUNËT E GËRMIMIT – pozicioni 2.1 dhe 2.4 dhe 8. PUNËT TJERA – pozicionet 8.2 dhe 8.3; AKSI II – 2. PUNËT E GËRMIMIT – pozicioni 2.4 dhe 8. PUNËT TJERA – pozicioni 8.2 dhe 8.3, pa implikime financiare shtesë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Zyra e Prokurimit, Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi i Drejtëpërdrejtë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Ofruesi i shërbimeve (punëkryesi) i kontratës me titull “Ndërtimi i rrugës Sapniq - Nashpall” me Nr. të Prokurimit 623-24-7151-5-1-1/C631, me datë 22.05.2026 i ka rekomanduar menaxherit të kontratës ndërrimin (kolaodimin) e pozicioneve në këtë kontratë, me qëllim të vazhdimit të punimeve të këtij projekti, pasi që disa pozicione nuk kanë nevojë të punohen, ndërsa disa pozicione të caktuara duhet zvogëluar sasia.

Pas kësaj, Menaxheri i Kontratës përmes kërkesës dhe rekomandimit me Nr. Prot. 1961 të datës 29.5.2026, ka kërkuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ ndërrimin (kolaodimin) e pozicioneve nga një pozicion në tjetrin, në kontratën me titull “Ndërtimi i rrugës Sapniq - Nashpall” me Nr. të Prokurimit 623-24-7151-5-1-1/C631 si në vijim: AKSI I - 6. INSTALIMET NËNTOKSORE – Pozicioni 6.1 dhe

6.2 dhe AKSI II – 6. INSTALIMET NËNTOKËSORE – Pozicioni 6.1 dhe 6.2, në pozicionet e domosdoshme për realizim: AKSI I – 2. PUNËT E GËRMIMIT – pozicioni 2.1 dhe 2.4 dhe 8. PUNËT TJERA – pozicionet 8.2 dhe 8.3; AKSI II – 2. PUNËT E GËRMIMIT – pozicioni 2.4 dhe 8. PUNËT TJERA – pozicioni 8.2 dhe 8.3, pa implikime financiare shtesë.

Ky ndërrim (kolaodim) i pozicioneve është bërë me qëllim të vazhdimit të punimeve të këtij projekti, pasi që disa pozicione nuk kanë nevojë të punohen, ndërsa disa pozicione të caktuara duhet zvogëluar sasia, me të cilin është rënë dakord me Operatorin Ekonomik dhe me Menaxherin e Kontratës dhe Mbikëqyrësin e Drejtëpërdrejtë të Menaxherit të Kontratës që të bëhet pa implikime financiare.

Pas konsultimit me Sektorin e Prokurimit, Menaxherin e kontratës dhe Mbikëqyrësin e drejtëpërdrejtë, si dhe pas vlerësimit të fakteve në shkresat e lëndës, është vendosur për ndërrim të pozicioneve në kontratën e lartpërmendur.

Andaj, duke u bazuar në atë që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- *Menaxheri i Kontratës,*
- *Mbikëqyrësit të Drejtëpërdrejtë,*
- *Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit,*
- *Zyrës së Prokurimit, dhe*
- *Arkivit.*

Smajl Latifi
Kryetari i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC



Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 7516 Nr. i faq./Br.str./No.pg 54

Data/Datum/Date 15 / 06 / 2016

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008"), nenit 40 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 43/2013"), dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave kundër aktvendimeve të Drejtorisë për Inspektim

1. **Caktohet** komisioni për shqyrtimin e ankesave kundër aktvendimeve të Drejtorisë për Inspektim, në këtë përbërje:
 - 1.1 Alban Gashi, kryesues
 - 1.2 Ivana Mojsić, anëtare
 - 1.3 Arsim Kastrati, anëtar
 - 1.4 Venhar Topalli, anëtar
 - 1.5 Shpejtim Mustafa, anëtar
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin e ankesave kundër aktvendimeve të Drejtorisë për Inspektim në Komunën e Rahovecit në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në ligjet dhe aktet tjera nënligjore në fuqi.
4. Mandati i komisionit për shqyrtimin e ankesave kundër aktvendimeve të Drejtorisë për Inspektim është 1 (një) vit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Inspektim, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi

Kryetari i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine

Mayor Office



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESIDENT OF MUNICIPALITY / MUNICIPAL MAYOR'S OFFICE

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 7524 Nr. i faq./Br.str./No.pg 55

Data/Datum/Date 17.06.26

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008"), nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 7 të Rregullores për dhënien e titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Rahovecit, me Nr. Prot. 01, Nr. 327/22, të datës 31.5.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të OVL të UÇK-së, dega në Rahovec, me nr. prot. 2097 të datës 15.6.2026, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për

Dhënien e Dekoratës "UKSHIN HOTI"

1. Me këtë vendim, Dekorata "UKSHIN HOTI", i jepet Adem Demaçit - pas vdekjes.
2. Kjo dekoratë i jepet për kontributin e jashtëzakonshëm në mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive kombëtare të shqiptarëve, për qëndresën e pathyeshme kundër shtypjes e shfytëzimit, për sakrificën e rrallë prej afro tri dekadash burgim politik në shërbim të idealit të lirisë, të çlirimit dhe të bashkimit të shqiptarëve, si dhe për veprimtarinë e tij të pandërprerë politike, qytetare, humanitare e letrare në dobi të çështjes kombëtare shqiptare, duke u shndërruar në simbol të rezistencës dhe të frymëzimit të brezave.
3. Bartësi i Dekoratës "UKSHIN HOTI", në emër të familjes nënshkruhet formalisht në regjistrin e bartësve të titujve të nderit, të dekoratave dhe të çmimeve të Komunës së Rahovecit.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Familjarëve të Adem Demaçit,
- OVL të UÇK-së, dega në Rahovec, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna Rahovec

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 7525 Nr. i faq./Br.str./No.pg. 55

Data/Datum/Date 17/06/26

Kryetari i Komunës së Rahovecit, duke u bazuar në nenin 13 dhe nënri 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe në nenin 25 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet Grupi i Vlerësimit për klasifikimin e pozitave të punës dhe hartimin e draft-formularëve për përshkrimin e detyrave të punës për kategorinë profesionale në Komunën e Rahovecit.

2. Grupi i Vlerësimit nga pika 1 e këtij vendimi përbëhet nga:

- Samir Mustafa – Kryesues
- Skender Hamza – Anëtar
- Kosovare Gashi – Anëtare

3. Grupi i Vlerësimit për klasifikim analizon dhe vlerëson pozitat e punës, harton propozimet për klasifikimin e pozitave dhe i paraqet për pëlqim dhe veprime të mëtejshme tek udhëheqësi më i lartë administrativ, përmes Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

A R S Y E T I M

Duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me qëllim të klasifikimit të pozitave të punës të kategorisë profesionale në Komunën e Rahovecit, konform nenit 25 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil, formohet Grupi i Vlerësimit si në pikën 1 të këtij vendimi.

Bazuar në sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me këtë vendim të njoftohen:

- Grupi i Vlerësimit
- Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- Arkivi

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës së Rahovecit





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – **Municipal Mayor**

REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINETI PRESIDENKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7526 Nr. i faq./Br.str./No.pg 55
Data/Datum/Date 17/06/26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Komisioni Komunal për Riintegrim, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale si dhe Rregullores së QRK-së, nr. 22/2020 neni 44, paragrafi 1, nënparagrafi 4.1, paragrafi 5, neni 21, paragrafi 1, 3 dhe 4 dhe Neni 33 paragrafi 6, andaj u vendos si në dispozitiv të Rregullores së QRK-së, nr. 22/2020, për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, mbështetur në vendimin e kryetarit të Komunës së Rahovecit, Nr. 271, të datës 14.7.2014, për themelimin e Komisionit Komunal për Riintegrim, në harmoni me Ligjin Nr. 05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nxjerr:

V E N D I M

1. APROVOHET kërkesa e z. [REDAKTUAR] i riatdhesuar nga Gjermania, i kthyer më datë 15.05.2025 me dhunë, për mbështetje nga Masat Emergjente të Riintegrit, për vazhdim edhe për 6 muaj, nga data 03.06.2026 deri më 02.01.2027, në vlerën prej 280 euro për çdo muaj, duke i përfshirë edhe shpenzimet komunale, sipas kërkesës me nr. 1990, të datës 02.06.2026, të parashtruar në ZKKK, në Komunën e Rahovecit dhe sipas ofertës më të lirë.
2. Përfitues nga pika 1 e këtij vendimi është familja një (1) anëtarëshe nga Komuna e Rahovecit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria e Punëve të Brendshme.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Komisioni Komunal për Riintegrim, në seancën e mbajtur më datë 08.06.2026, ka shqyrtuar kërkesën për vazhdimin e mbështetjes nga Masat Emergjente të Riintegrit të parashtruar nga [REDAKTUAR] i riatdhesuar nga Gjermania.

Pas analizimit të dokumentacionit përkatës, verifikimit të gjendjes dhe shqyrtimit të anamnezës sociale të përpiluar nga Qendra për Punë Sociale në Rahovec, është konstatuar se i njëjti vazhdon të gjendet në gjendje të rënduar socio-ekonomike dhe pa zgjidhje të qëndrueshme të banimit, dhe me përballje të rënde të sëmundjeve shoqëruese.

Sipas të dhënave nga anamneza sociale:

- përfituesi nuk posedon pronë të banueshme në dispozicion;
- është i varur nga mbështetja institucionale për sigurimin e strehimit;
- nuk ka të ardhura të qëndrueshme financiare;
- gjendja e tij sociale dhe ekonomike nuk mundëson mbulimin e shpenzimeve bazë të jetesës dhe të banimit pa mbështetje.

Këto rrethana e kategorizojnë [REDAKTUAR] si rast me gjendje të vështirë, në harmonizim me Rregulloren (QRK) nr. 22/2020, duke justifikuar vazhdimin e mbështetjes në kuadër të masave emergjente të riintegrit.

Duke u bazuar në neni 44, paragrafi 1, nënparagrafi 4.1, paragrafi 5, neni 21, paragrafi 1, 3 dhe 4 dhe Neni 33 paragrafi 6 si dhe në rekomandimet e ZKKK-së, Komisioni ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore për vazhdimin e mbështetjes me akomodim me qira.

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh pas pranimit të tij, mund të paraqesë ankesë në Komisionin e Ankesave.

Vendimit u dërgohet:

1. Të riatdhesuar [REDAKTUAR]
2. Koordinatorit Rajonal të MPB-se,
3. Zyrës Komunale për Kthim dhe Komunitete, dhe
4. Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine

Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02/Kabineti i Kryetarit të Komunës

Nr./Br./No 7534 Nr. i faq./Br.str./No.pg 56

Data/Datum/Date 22 /06 /26

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 21 dhe 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016"), nenit 11 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 13/2019"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për qasje në dokumente publike

1. **Miratohet** e bazuar kërkesa me nr. prot. 02/7532, e datës 19.6.2026, për qasje në dokumente publike nga Aurora Tafili nga Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGI) dhe i ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike dhe atë: vendimet, proceset dhe obligimet institucionale që lidhen me mbrojtjen dhe me promovimin e të drejtave të fëmijëve.
2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Në mbështetje të nenit 10, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (QDP), Komuna e Rahovecit ka pranuar kërkesën me nr. prot. 02/7532, të datës 19.6.2026, për qasje në dokumente publike nga Aurora Tafili nga Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGI).

Pas shqyrtimit të kërkesës, ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike si në dispozitiv të këtij vendimi dhe atë: vendimet, proceset dhe obligimet institucionale që lidhen me mbrojtjen dhe me promovimin e të drejtave të fëmijëve në komunën e Rahovecit.

Kërkesa për qasje në dokumente publike është pranuar në mënyrë elektronike.

Komuna e Rahovecit, pas shqyrtimit të kërkesës, si dhe pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimit të tij.

Vendimi u dërgohet:

- **Blerta Gashit, Zyrtare për shqyrtimin fillestar të QDP-së,**
- **Aurora Tafilit nga KLGI, dhe**
- **Arkivit.**





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No <u>7536</u> Nr. i faq./Br.str/No.pg <u>56</u>
Data/Datum/Date <u>22.06.26</u>
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 68 paragrafi 1 pika 1.2, lidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2023"), nenit 13 paragrafi 3 pika 2.1 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2/2025"), konform nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.3.2017 dhe kërkesës së Brikena Osa nga Rahoveci me nr. prot. 2105 të datës 16.6.2026, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për pezullimin e marrëdhënies së punës

1. Brikena Osa, e sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Edukatore në SHFMU "Isa Boletini" në Rahovec, i pezullohet marrëdhënia e punës, pa pagesë, nga data 19.6.2026 deri në përfundim të mandatit të rregullt si drejtoreshë e IEFH "Tulipanët" në Rahovec, nëse ky pezullim nuk ndërpritet më herët.
2. Të lartpërmendurës i ruhet vendi i punës së edukatores në SHFMU "Isa Boletini" në Rahovec dhe njëkohësisht e ruan të drejtën e kthimit në pozitën e mëparshme pas përfundimit të mandatit të drejtorit të shkollës ose edhe më herët me kërkesën e saj.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim, Njësia e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Brikena Osa, e sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Edukatore në SHFMU "Isa Boletini" në Rahovec, pas zhvillimit të procedurave të konkursit, është emëruar drejtoreshë në IEFH "Tulipanët" në Rahovec nga data 1.6.2026.

Andaj, Kryetari i Komunës në cilësinë e Zyrtarit Kryesor Administrativ, në zbatim të nenit 68 paragrafi 1 pika 1.2, lidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2023") dhe nenit 13 paragrafi 3 pika 2.1 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2/2025"), e konform nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor

dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, e pezullon nga marrëdhënia e punës pa pagesë Brikena Osa nga data 19.6.2026 deri në përfundimin e mandatit të rregullt të drejtoreshës në IEFH "Tulipanët" në Rahovec, nëse ky pezullim nuk ndërpritet më herët, dhe njëkohësisht e ruan të drejtën e kthimit në pozitën e mëparshme pas përfundimit të mandatit të drejtorit të shkollës ose edhe më herët me kërkesën e tij.

Andaj, duke u bazuar në atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të vendimit, Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa në Komunën e Rahovecit.

Vendimi u dërgohet:

- *Brikena Osa nga Rahoveci,*
- *Drejtorisë për Arsim,*
- *Zyrtarit/es për paga në Drejtorinë për Arsim,*
- *Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,*
- *NJMBNJ, dhe*
- *Arkivit.*

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESIEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No <u>7537</u> Nr. i faq/Br.str/No.pg <u>56</u>
Data/Datum/Date <u>22 / 06 / 26</u>
RAHOVEC / GRAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 68 paragrafi 1 pika 1.2, lidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2023"), nenit 13 paragrafi 3 pika 2.1 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2/2025"), konform nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.3.2017 dhe kërkesës së Faruk Paçarizi nga Rahoveci me nr. prot. 2049 të datës 9.6.2026, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për pezullimin e marrëdhënies së punës

1. Faruk Paçarizi, i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Mësimdhënës i gjuhës dhe letërsisë angleze në SHFMU "Gëzim Hamza - Piktori" në Rahovec, i pezullohet marrëdhënia e punës, pa pagesë, nga data 19.6.2026 deri në përfundim të mandatit të rregullt si drejtor i SHFMU "Gëzim Hamza - Piktori" në Rahovec, nëse ky pezullim nuk ndërpritet më herët.
2. Të lartpërmendurit i ruhet vendi i punës së mësimdhënësit në SHFMU "Gëzim Hamza - Piktori" në Rahovec dhe njëkohësisht e ruan të drejtën e kthimit në pozitën e mëparshme pas përfundimit të mandatit të drejtorit të shkollës ose edhe më herët me kërkesën e tij.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim, Njësia e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Faruk Paçarizi, i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Mësimdhënës i gjuhës dhe letërsisë angleze në SHFMU "Gëzim Hamza - Piktori" në Rahovec, pas zhvillimit të procedurave të konkursit, është emëruar drejtor në SHFMU "Gëzim Hamza - Piktori" në Rahovec nga data 1.6.2026.

Andaj, Kryetari i Komunës në cilësinë e Zyrtarit Kryesor Administrativ, në zbatim të nenit 68 paragrafi 1 pika 1.2, lidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2023") dhe nenit 13 paragrafi 3 pika 2.1 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2/2025"), e konform nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor

dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, e pezullon nga marrëdhënia e punës pa pagesë Faruk Paçarizi nga data 19.6.2026 deri në përfundimin e mandatit të rregullt të drejtorit të SHFMU “Gëzim Hamza - Piktori” në Rahovec, nëse ky pezullim nuk ndërpritet më herët, dhe njëkohësisht e ruan të drejtën e kthimit në pozitën e mëparshme pas përfundimit të mandatit të drejtorit të shkollës ose edhe më herët me kërkesën e tij.

Andaj, duke u bazuar në atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të vendimit, Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa në Komunën e Rahovecit.

Vendimi u dërgohet:

- *Faruk Paçarizi nga Rahoveci,*
- *Drejtorisë për Arsim,*
- *Zyrtarit/es për paga në Drejtorinë për Arsim,*
- *Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,*
- *NJMBNJ, dhe*
- *Arkivi.*

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E ORAHOVAC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNES/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET	
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)	
Nr./Br./No	7538 Nr. i faq/Br.str/No.pg 56
Data/Datum/Date	22 / 06 / 26
RAHOVEC / ORAHOVAC	

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 68 paragrafi 1 pika 1.2, lidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2023"), nenit 13 paragrafi 3 pika 2.1 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2/2025"), konform nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.3.2017 dhe kërkesës së Skënder Krasniqi nga fshati Opterushë me nr. prot. 2096 të datës 15.6.2026, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për pezullimin e marrëdhënies së punës

1. Skënder Krasniqi, i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Mësimdhënës i lëndës së historisë në SHFMU "Lidhja e Prizreni" në Opterushë, i pezullohet marrëdhënia e punës, pa pagesë, nga data 19.6.2026 deri në përfundim të mandatit të rregullt si drejtor i SHFMU "Lidhja e Prizreni" në Opterushë, nëse ky pezullim nuk ndërpritet më herët.
2. Të lartpërmendurit i ruhet vendi i punës së mësimdhënësit në SHFMU "Lidhja e Prizreni" në Opterushë dhe njëkohësisht e ruan të drejtën e kthimit në pozitën e mëparshme pas përfundimit të mandatit të drejtorit të shkollës ose edhe më herët me kërkesën e tij.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim, Njësia e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Skënder Krasniqi, i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Mësimdhënës i lëndës së historisë në SHFMU "Lidhja e Prizreni" në Opterushë, pas zhvillimit të procedurave të konkursit, është emëruar drejtor në SHFMU "Lidhja e Prizreni" në Opterushë nga data 1.6.2026.

Andaj, Kryetari i Komunës në cilësinë e Zyrtarit Kryesor Administrativ, në zbatim të nenit 68 paragrafi 1 pika 1.2, lidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2023") dhe nenit 13 paragrafi 3 pika 2.1 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2/2025"), e konform nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor

dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, e pezullon nga marrëdhënia e punës pa pagesë Skënder Krasniqi nga data 19.6.2026 deri në përfundimin e mandatit të rregullt të drejtorit të SHFMU “Lidhja e Prizreni” në Opterushë, nëse ky pezullim nuk ndërpritet më herët, dhe njëkohësisht e ruan të drejtën e kthimit në pozitën e mëparshme pas përfundimit të mandatit të drejtorit të shkollës ose edhe më herët me kërkesën e tij.

Andaj, duke u bazuar në atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të vendimit, Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa në Komunën e Rahovecit.

Vendimi u dërgohet:

- *Skënder Krasniqi nga fshati Opterushë,*
- *Drejtorisë për Arsim,*
- *Zyrtarit/es për paga në Drejtorinë për Arsim,*
- *Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,*
- *NJMBNJ, dhe*
- *Arkivit.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO	
RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET	
Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)	
Nr./Br./No	7539
Nr. i faq./Br.str./No.pg.	56
Data/Datum/Date	22 / 06 / 26
RAHOVEC / ORAHOVAC	

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 68 paragrafi 1 pika 1.2, lidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyratë Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2023"), nenit 13 paragrafi 3 pika 2.1 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyratë Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2/2025"), konform nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.3.2017 dhe kërkesës së Shemi Ibrahimit nga Prizreni me nr. prot. 2025 të datës 8.5.2026, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për pezullimin e marrëdhënies së punës

1. Shemi Ibrahimit, i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Mësimdhënës i lëndës së kimisë në SHML "Ukshin Hoti" në Krushë të Madhe, i pezullohet marrëdhënia e punës, pa pagesë, nga data 19.6.2026 deri në përfundim të mandatit të rregullt si drejtor i SHFMU "Faik Konica" në Celinë, nëse ky pezullim nuk ndërpritet më herët.
2. Të lartpërmendurit i ruhet vendi i punës së mësimdhënësit në SHML "Ukshin Hoti" në Krushë të Madhe dhe njëkohësisht e ruan të drejtën e kthimit në pozitën e mëparshme pas përfundimit të mandatit të drejtorit të shkollës ose edhe më herët me kërkesën e tij.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim, Njësia e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Arsyetim

Shemi Ibrahimit, i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Mësimdhënës i lëndës së kimisë në SHML "Ukshin Hoti" në Krushë të Madhe, pas zhvillimit të procedurave të konkursit, është emëruar drejtor në SHFMU "Faik Konica" në Celinë nga data 1.6.2026.

Andaj, Kryetari i Komunës në cilësinë e Zyrtarit Kryesor Administrativ, në zbatim të nenit 68 paragrafi 1 pika 1.2, lidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyratë Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2023") dhe nenit 13 paragrafi 3 pika 2.1 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyratë Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2/2025"), e konform nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor

dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, e pezullon nga marrëdhënia e punës pa pagesë Shensi Ibrahimini nga data 19.6.2026 deri në përfundimin e mandatit të rregullt të drejtorit të SHFMU “Faik Konica” në Celinë, nëse ky pezullim nuk ndërpritet më herët, dhe njëkohësisht e ruan të drejtën e kthimit në pozitën e mëparshme pas përfundimit të mandatit të drejtorit të shkollës ose edhe më herët me kërkesën e tij.

Andaj, duke u bazuar në atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

